

V E N D I M
Nr.781, datë 11.11.1996

PËR PRIVATIZIMIN E NDËRMARRJEVE DHE OBJEKTEVE SHTETËRORE

Me propozimin e Ministrisë së Privatizimeve dhe Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Me këtë vendim ndërmarrje dhe objekte konsiderohen çdo njësi prodhimi, shërbimi, pjesë të tyre, mjete lundrimi e mjete xhiroje që janë konsideruar të shiten si pasuri fizike, ose të shkëputura nga programi i privatizimit masiv.

2. Privatizimi i ndërmarrjeve dhe objekteve do të bëhet nëpërmjet ankandit.

Privatizimi bëhet pa ankand vetëm për këto raste:

a) Për ish-pronarët e tokës, në zbatim të së drejtës së parablerjes, sipas ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave të ish-pronarëve”.

b) Automjetet, makineritë, pajisjet e mjetet e punës, për të cilat do të jetë vendosur të shiten të shkëputura nga objektet, në favor të punonjësve që i kanë në përdorim. Në rast se punonjësit që i kanë pasur në përdorim, nuk bëjnë kërkesë për blerjen e tyre, atëherë ato kalojnë në ankand.

3. Nuk lejohet të bëhet kalimi kapital i ndërmarrjes ose objekteve që janë publikuar për shitje.

4. Procedura e publikimit fillon pasi të jenë dorëzuar në AKP ose në degën e AKP-së dokumentet e vlerësimit të objektit. AKP ose dega e AKP-së e pranon dosjen e objektit, në qoftë se ka dokument të rregullt se është kaluar në strukturat përkatëse të Ministrisë së Privatizimeve. Në të kundërtën kërkohet plotësimi i dokumentacionit.

Kur ndërmarrja, e cila ka pasur objektin në administrim të saj, ka nënshkruar një kontratë bashkëpunimi a qiraje me një palë të tretë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, kontratat janë të detyrueshme për t’u pranuar nga pronari i ri. Ky fakt duhet të jetë pjesë e dokumenteve të objektit që dorëzohen në degën e AKP-së ose AKP nga strukturat e Ministrisë së Privatizimeve.

Dega e AKP, me të pranuar dokumentet e vlerësimit të objektit, fillon publikimin për privatizim. Periudha e publikimit nuk duhet të zgjatë më tepër se 20 ditë nga njoftimi i parë.

a) Vendoset një njoftim në dy gazetatat me qarkullim kombëtar, të paktën katër herë në dy javët e para.

b) Vendoset një njoftim në një gazetë të rrethit ku ndodhet objekti, të paktën dy herë në dy javët e para, dhe bëhet njoftim me afishe për periudhën që mbetet, por jo më pak se katër vende.

Kur nuk ka mundësi botimi në gazetë lokale, njoftimi bëhet me afishe jo më pak se në gjashtë vende. Afisheet detyrimisht vendosen në vendndodhjen e degës së AKP-së, në qendrën e banuar ku ndodhet objekti, si dhe në vetë objektin që privatizohet.

Këto njoftime duhet të specifikojnë informacionin e mëposhtëm:

- Emrat dhe vendet e objekteve që privatizohen.

- Vlefëta fillestare e ankandit, ku përfshihet vlera e objektit, investimet e bëra nga qiramarrësi etj.

- Sipërfaqja e objektit.

5. Kryetari i degës së AKP-së harton dhe arkivon një proces-verbal që mban: emrin e gazetës, datat kur janë botuar njoftimet, si dhe numrin e afisheve sipas vendeve ku janë vendosur.

6. Kushdo që dëshiron të marrë pjesë në ankand duhet të paraqesë këto dokumente:

a) Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit.

b) Një mandat që tregon pagesën e 20 % të vlefës së fillimit të ankandit në lekë, e cila paguhet në llogarinë përkatëse të AKP-së detyrimisht brenda afatit të kërkesave.

7. Ish-pronari i tokës, bashkëngjitur kërkesës për blerjen e ndërmarrjes ose objektit që shtrihet mbi tokën ish-pronë e tij, duhet të paraqesë në AKP ose në degën e saj, përveç sa kërkohet në pikën 6, edhe vendimin përkatës të komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve, që përcakton se ai është ish-pronar i tokës.

Në raste të veçanta dega e AKP-së kërkon dokument shtesë nga komisioni i kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve se toka nën objekt përputhet me tokën ish-pronë, duke

përcaktuar edhe përqindjen përkatëse të përputhjes, kur kjo nuk është përcaktuar qartë në vendimin përkatës të komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve. E drejta e parablerjes të ish-pronarit të tokës duhet të ushtrohet deri në 5000 metra katrorë nën objekt.

Vendimi i komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve duhet të dorëzohet në degën e AKP-së ose AKP detyrimisht deri para zhvillimit të ankandit. Në rastin e kundërt ish-pronari i truallit e humbet të drejtën e parablerjes dhe i nënshtrohet ankandit.

Kur sipërfaqja e tokës ish-pronë private shtrihet mbi 80 % të gjithë tokës nën objekt, e drejta e parablerjes shtrihet në gjithë objektin. Kjo edhe për rastet kur ka disa bashkëpronarë e ndërmjet tyre ka një marrëveshje të dokumentuar.

Në rastet kur objektit i është ulur vlefë e fillimit të ankandit (si pasojë e mosshitjes me çmimin fillestar të publikuar), ish-pronari, për të gëzuar të drejtën e parablerjes, duhet të bëjë pagesën e plotë sipas vlefës fillestare dhe jo sipas vlefës së ulur.

8. Vendi dhe ora e saktë e fillimit të ankandit shpallet jo më vonë se 4 ditë nga afati i fundit i pranimit të kërkesave. Data, vendi dhe ora e zhvillimit të ankandit bëhet me njoftim publik.

Nëse ndryshohet data e zhvillimit të ankandit nga AKP ose dega e AKP, duhet të përsëritet procedura e njoftimit në ankand për datën e re, e cila vendoset jo më vonë se 5 ditë nga data e parë.

9. Komisioni i ankandit përbëhet nga këta persona:

- Përfaqësuesi i AKP..... kryetar
- Përfaqësuesi i Ministrisë së Privatizimeveanëtar
- Përfaqësuesi i organit që ka në administrim objektin.....anëtar

Për ankandet që zhvillohen në degët e AKP në rrethe, anëtarë të komisionit të ankandit janë:

- Përfaqësuesi i degës së AKP kryetar
- Përfaqësuesi i Ministrisë së Privatizimeveanëtar
- Përfaqësuesi i organit që ka në administrim objektin.....anëtar

Pjesëmarrja e komisionit të ankandit (kryetarit dhe anëtarit) në datën dhe orën e

caktuar për ankand është e detyrueshme.

Komisioni i ankandit ka këto detyra:

- Të sigurojë, që para nisjes së ankandit, nëse gjithë pjesëmarrësit në ankand janë të regjistruar dhe identifikuar sipas letërnjoftimit a certifikatës së gjendjes civile ose me prokurë të veçantë përfaqësimi.

- Të paraqesë anëtarët e komisionit të pjesëmarrësit.
- Të deklarojë vlefën fillestare të ankandit.
- Të drejtojë marrjen e ofertave.

Në raportin përfundimtar të ankandit duhet:

- Të tregohet dhe vërtetohet rregullshmëria e drejtimit të ankandit.
- Të dëshmohet se ofertat janë dhënë në përputhje me kushtet e caktuara.
- Të regjistrohet vlefë dhe pala fituese.

10. Fituesi i ankandit të ndërmarrjes ose objektit shpallet ai pjesëmarrës që ofron çmimin më të lartë.

Pjesëmarrësve të tjerë (përveç fituesit) i kthehet 20 % e vlefës fillestare të paguar paraprakisht, sipas kërkesës me shkrim të bërë prej tyre.

11. Personi që ka fituar të drejtën e blerjes së objektit nëpërmjet ankandit ose me të drejtën e parablerjes nga ana e AKP apo dega e saj, pajiset me autorizimin për kalim pronësie. Në këtë autorizim duhet të jenë përcaktuar qartë detyrimet e blerësit.

12. Nëse personi që ka fituar të drejtën e blerjes së ndërmarrjes ose objektit nuk paguan brenda 30 ditëve vlefën e plotë nga dita e paraqitjes si pronar toke apo ankandit, ai e humbet të drejtën e blerjes dhe ndërmarrja ose objekti rishpallet për shitje nga fillimi.

13. Blerësi ka të drejtë të bëjë pagesën në lekë dhe letra me vlerë të lëshuara për privatizim, ku 20 % e vlefës fillestare të ndërmarrjes ose objektit paguhet në lekë, nga të cilat 5 % mbahen si e ardhur e AKP-së.

14. Pas realizimit të detyrimeve, nënshkruhet kontrata e shitjes nga pala shitëse (përfaqësuesi i AKP, drejtori ose likuidatori i objektit) dhe blerësi privat.

Në rastet kur objekti nuk ka drejtor ose likuidator, në emër të tyre kontrata nënshkruhet nga drejtuesi që mbulon sektorin përkatës nga varet objekti, në ministri ose pushtetin lokal.

Nënshkrimi i kontratës nga përfaqësuesit e shtetit dhe dorëzimi i objektit nga likuidatori ose drejtori është i detyrueshëm.

Marrja në dorëzim e ndërmarrjes ose objektit nga blerësi bëhet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.589, datë 16.10.1995.

15. Objektet, për të cilat procesi i privatizimit ka filluar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.203, datë 3.5.1995 dhe ndryshimet përkatëse, të vazhdojnë procedurën sipas atij vendimi.

16. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.203, datë 3.5.1995 “Për privatizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme”; nr.386, datë 26.7.1993 “Për dhënien me qira të objekteve shtetërore”; nr.403, datë 15.8.1994; nr.84, datë 12.2.1996; nr.185, datë 18.3.1996; nr.205, datë 25.3.1996 dhe të gjitha aktet e tjera nënligjore që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

17. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Privatizimeve dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi